



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/63


Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

**KONCEPT DOKUMENTI PËR FUSHËN E BASHKËPUNIMIT JURIDIK
NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET CIVILE**

Titulli: Koncepti dokumenti për fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Kapitulli 1: Hyrje

Në kuadër të Planit Vjetor të Punës të Qeverisë ("PVPQ") për vitin 2017, pjesa e Ministrisë së Drejtësisë (Tabela B, Objektivi nr. 2, pika 2.2), është paraparë hartimi i Koncepti dokumenti për fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Ky aktivitet është bartur edhe në PVPQ 2018 (Tabela B, objektivi nr. 2, pika 2.2). Po ashtu, rregullimi i kësaj fushe parashihet edhe me Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) për vitin 2017 dhe 2018, në kapitullin 24, neni 83 i MSA-së, *Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile*. Gjithashtu, ky Koncepti Dokument është paraparë edhe në Listën e Koncepti Dokumenteve për vitin 2018, me numër rendor 12.

Për më tepër, në Raportin për Shtetin të Komisionit Evropian, të publikuar në prill 2018, është theksuar që një kornizë ligjore për bashkëpunim gjyqësor në çështjet civile do të ndihmonte në sqarimin e rregullave dhe procedurave. Ministria e Drejtësisë në Planin Zhvillimor Strategjik të saj 2018-2021, parasheh që përmes objektivës së dytë, "Avancimi i ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar", të bëhet përmirësimi i kornizës ligjore për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile.

Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë 2016-2019 objektivi 10.1. (Objektivi strategjik) përcakton përmirësimin e pavarësisë, eficiencës, efektivitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë, më në veçanti përf forcimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje të ndryshme gjyqësore.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN) i Ministrisë së Drejtësisë, ndër të tjera është përgjegjës për trajtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndihmën juridike ndërkombëtare në rastet civile, të pranuar apo lëshuara nga Kosova përmes kanaleve diplomatike. Meqenëse Kosova akoma nuk është palë e Konferencës së Hagës, Konventës Evropiane ose Kombeve të Bashkuara, shumica e këtyre kërkesave të çështjeve civile dërgohen përmes kanaleve formale diplomatike dhe DBJN-së. Kështu, format alternative të komunikimit apo transmetimit të kërkesave akoma nuk janë formalizuar përmes marrëveshjeve të tilla ndërkombëtare dhe bilaterale.

Deri më datën 20 mars 2009, fusha e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar ka qenë kompetencë plotësisht e rezervuar e departamentit të drejtësisë së UNMIK-ut. Ministria, duke i'u përshtatur rrethanave të reja juridike dhe politike pas shpalljes së pavarësisë së Republikës të Kosovës me datë 17 shkurt 2008, ka marrë kompetencat sa i përket fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile.

Me këtë rast, Ministria ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ mbi ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare në fushën e çështjeve penale dhe civile. Me këtë Udhëzim, në përputhje me rrethanat e reja të krijuara dhe ligjin e aplikueshëm penal në Kosovë, Ministria ka marrë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë sa i përket ndihmës juridike ndërkombëtare nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, fillimisht për të gjitha shtetet që kanë njohur shtetin e Kosovës. Gjatë shtatorit të vitit 2009, Ministria ka plotësuar Udhëzimin Administrativ të datës 20 mars 2009, dhe ka shtrirë kompetencat e saja sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar edhe për të gjitha shtetet tjera të cilat nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës.

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për përafrimin e legjislacionit vendor me instrumente ndërkombëtare që e rregullojnë këtë fushë, e në veçanti me instrumentet e BE-së në fuqi dhe Konventat e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Siç u theksua më lartë, Republika e Kosovës nuk ka aderuar në Konventat e Konferencës së Hagës që rregullojnë bashkëpunimin juridik në çështjet civile, si dhe kemi një numër shumë të vogël të marrëveshjeve bilaterale në këto çështje. Në këtë mënyrë bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile ka mbetur i parregulluar ligjërisht. Vakuumi ligjor i krijuar, në praktikë, ka shkaktuar vështirësi të kohëpaskohshme në ofrimin e shërbimeve ligjore në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, sidomos në ekzekutimin e kërkesave të organeve gjyqësore të Republikës së Kosovës.

Udhëzimi Administrativ në fuqi rregullon vetëm në mënyrë të përgjithësuar transmetimin e kërkesave dhe përgjigjeve për ndihmë juridike të ndërsjellë, pa ofruar rregulla të qarta materiale dhe procedurale. Ky Udhëzim nuk përcakton kushte formale që duhet të plotësojë një kërkesë për ndihmë juridike në mënyrë që të pranohet dhe përmbushet nga organet gjyqësore në Kosovë. Për shembull, nuk është e qartë se cilat dokumente duhet të dërgohen së bashku me kërkesën; nëse ato duhet të jenë në origjinal apo nëse mjafton kopja e vërtetuar; në cilat gjuhë mund të dërgohen kërkesat; cilat janë afatet e transmetimit; nuk rregullohet procedura që duhet ndjekur gjatë ekzekutimit të kërkesave. Ndërsa sa i përket rregullave materiale, aktualisht as UA dhe asnjë ligj, nuk i përcakton format e ndihmës juridike (shërbimin e dokumenteve, letërthirrjeve, marrjen e dëshmimeve etj) që mund të kërkohet apo ofrohet. Në të njëjtën mënyrë nuk është e rregulluar se në lidhje me cilat procedura mund të ofrohet ndihma (familjare, trashëgimore, përmbarrimore, tregtare, të falimentimit etj). Po ashtu, nuk përcaktohen rastet në të cilat ndihma mund apo duhet të refuzohet (përveç nëse është në kundërshtim me rendin juridik, neni 285 i Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Përkundër faktit që disa ligje vendore (të listuara më poshtë), përmbajnë dispozita lidhur me ndihmën juridike të ndërsjellë, ato ligje përmbajnë dispozita të përgjithësuar dhe nuk trajtojnë mjaftueshëm ofrimin e ndihmës, sidomos lidhjen e aspektit ndërkombëtar me procedurën vendore sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore. Po ashtu, këto akte ligjore, në masë të madhe, rregullojnë ofrimin e ndihmës së kërkuar nga organet gjyqësore të një shteti tjetër nga organet gjyqësore në Kosovë, por jo edhe kërkimin e ndihmës nga një shtet tjetër. Për më tepër, këto dispozitat nuk janë të

përafruara me aktet ndërkombëtare që e rregullojnë këtë fushë. Mungesa e një akti juridik të unifikuar që rregullon kërkimin dhe ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet civile, ka krijuar një situatë me paqartësi dhe dilema tek institucionet përgjegjëse për pranimit dhe ekzekutimin e këtyre kërkesave, Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat. Në këtë drejtim në vazhdimësi ka pasur ankesa nga gjyqësori, të cilët kanë theksuar se pas pranimit të një kërkesë nga një organ gjyqësor i një vendi tjetër, në mungesë të rregullave të qarta, shpesh hasin në dilema se si të veprojnë. Në raste të tilla zbatojnë dispozita të ligjeve tjera me analogji, apo ka raste edhe kur ndihma duhet të refuzohet. Vlen të përmendet që ka patur edhe raste kur ndihma është refuzuar për shkak se ka munguar baza ligjore për ekzekutim të kërkesës, si p.sh. refuzimi i kërkesave për marrje në pyetje të dëshmitarëve përmes video-konferencës, e cila nuk është e rregulluar si duhet me legjislacionin aktual. Vonesat në kthimin e përgjigjeve apo refuzimi i ndihmës ndikon negativisht në imazhin e Republikës së Kosovës tek shtetet tjera që kërkojnë këtë ndihmë.

Ngjashëm, vështirësi të tilla shfaqen në rastet kur gjatë zhvillimit të procedurës pranë gjykatave tona është e nevojshëm ndërmarrja e ndonjë veprimi procedural në një shtet tjetër. Marrë parasysh mungesën e definimit të qartë se çfarë elemente duhet të përmbaj një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë drejtuar një shteti tjetër dhe me cilat dokumente duhet të shoqërohet ajo, janë shkaktuar vonesa dhe dilema në tërë procedurën. Si pasojë, në shumë raste shtetet tjera kthejnë përgjigje negative apo kërkojnë plotësimin e letërporosisë me elemente apo dokumente shtesë. Përsëritja e kërkesës domosdoshmërisht shkakton vonesa dhe zvarritje të procedurave gjyqësore. Në këtë mënyrë cenohet e drejta e palëve në procedurë për një gjykim të drejtë, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin 31 dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pyetësori për masat legislative sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Gjatë përgatitjes së analizës së këtij problemi, Ministria e Drejtësisë ka dërguar në organet gjyqësore një pyetësor lidhur me vështirësitë dhe nevojat e gjyqësorit sa i përket fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Në përgjigje të kësaj kërkesë të Ministrisë, gjyqtarët kanë theksuar se në rastet e shqyrtimit të kërkesave që i pranojnë apo i dërgojnë për ndihmë juridike ndërkombëtare, bazohen kryesisht në Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Ofrimit të Ndihmës Juridike Ndërkombëtare në çështjet penale dhe civile (të miratuar nga Ministria e Drejtësisë), Ligjin për Procedurën Kontestimore, Ligjin për Zgjidhjen e Konflikteve të Ligjeve (LZKL - Gazeta zyrtare e ish RSFJ 43/1982), si dhe ligjet e tjera sistematike.

Në përgjigje të këtij pyetësori, gjyqtarët pothuajse në mënyrë unanime, konsiderojnë se rregullat në fjalë, nuk ofrojnë zgjidhje të mjaftueshme për rastet që i pranojnë. Kjo ndodhë për shkak të zbrazëtirave ligjore që ekzistojnë në këto ligje/udhëzime administrative. Arsye tjetër është se nga perspektiva e tanishme, disa aspekte të ligjeve përkatëse, duke i marrë për bazë sistemet juridike bashkëkohore, duken të tejkaluara, ngase në situata të caktuara ne shërbehemi me LZKL e vitit 1982. Po ashtu, përmendin të kenë pasur raste kur janë përballur me dilema në vendosje apo dhe në dhënien e mendimeve apo opinioneve ligjore në lidhje me zbatimin e legjislacionit për çështje të caktuara të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Gjatë vlerësimit të përgjigjeve në pyetjet e këtij pyetëso, shihet se Udhëzimi Administrativ që aktualisht është në fuqi, konsiderohet si një zgjidhje e përkohshme e trajtimit të çështjeve që ndërlidhen me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Si rekomandim i përgjigjeve të këtij pyetëso del se çështjet të cilat kanë të bëjnë me ndihmën juridike ndërkombëtare në çështjet civile duhet të rregullohen me ligj, si dhe me lidhjen e marrëveshjeve bilaterale.

Konventat bilaterale dhe multilaterale

Në bazë të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës (2008), Kosova ka marrë përsipër detyrimet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato të nënshkruara në emër të saj nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), traktate si dhe detyrimet tjera të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (ish-RSFJ), me të cilat ka pasur detyrime si ish pjesë përbërëse, përfshirë edhe Konventat e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike dhe Konsullore (1961). Neni 145 i Kushtetutës së Kosovës të vitit 2008 thekson: "Marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet e tjera për bashkëpunimin ndërkombëtarë, që janë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të vazhdojnë të respektohen deri atëherë kur ato marrëveshje ose akte të rinegociohen ose kur të bëhet tërheqja nga to në pajtueshmëri me kushtet e tyre ose deri atëherë kur ato të zëvendësohen nga marrëveshje ose akte të reja ndërkombëtare me të cilat mbulohen fushat e njëjta dhe që janë miratuar në pajtim me këtë Kushtetutë." Deri më tani nuk është bërë tërheqje formale nga ndonjë marrëveshje bilaterale përkatëse e ish-RSFJ-së, e as nuk janë zëvendësuar me marrëveshje të reja bilaterale, edhe pse në disa raste janë bërë shkëmbime të notave diplomatike me partnerët kontraktues.

Kështu, në procesin e suksedimit të marrëveshjeve bilaterale të nënshkruara nga ish-RSFJ me shtetet tjera, janë marrë përsipër këto marrëveshje në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje civile:

Britania e Madhe:

- Konventa mes Madhërisë së Tij në emër të Britanisë së Madhe dhe Mbretit të Jugosllavisë në lidhje me procedurën ligjore në çështje civile dhe komerciale (Londër, 27 shkurt 1936).

Mbretëria e Belgjikës:

- Marrëveshja e lidhur ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë lidhur me ndihmën e ndërsjellë gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare (Beograd, 24 shtator 1971);
- Konventa ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjen e detyrimit për alimentacion (Beograd 12 dhjetor 1973).

Republika Çeke:

- Marrëveshja në mes të RSFJ-së dhe RS të Çekosllovakisë për rregullimin e marrëdhënieve ligjore në çështjet civile, familjare dhe penale (Beograd, 20 janar 1964);

Franca

- Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës Franceze dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare (Paris, 18 maj 1971);
-
- Marrëveshja në mes të Republikës Franceze dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë me synimin për të lehtësuar zbatimin e Marrëveshjes së Hagës, të 1 marsit 1954 lidhur me procedurën civile (Beograd, 29 tetor 1969).

Deri më tash Kosova nuk e ka nënshkruar asnjë konventë bilaterale ose multilaterale me shtetet e Ballkanit Perëndimor, ose me ndonjë shtet tjetër evropian, përveç aderimit në Konventën e Konferencës së Hagës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja, e ashtuquajtura Konventa e Apostilit, e 5 tetorit 1961. Në veçanti, Republika e Kosovës nuk është pjesë e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (Konferenca e Hagës), organizatës dominuese botërore ndërqeveritare që punon drejt një unifikimi progresiv të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private. Në vitin 2011, Ministria e Drejtësisë së Kosovës ka aplikuar në Konferencën e Hagës për të marrë pjesë në seminare dhe konferenca të organizatës.

Në Planin Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2017-2021, Ministria e Drejtësisë ka paraparë që të zhvillojë aktivitete në drejtim të inicimit të procedurave për aderim në Konventat e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Ministria e Drejtësisë planifikon që, në koordinim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, gjatë vitit 2018 të fillojë me procedurat për aderim në disa konventa. Në zbatim të kësaj, Ministria e Drejtësisë aktualisht është duke shqyrtuar se cilat konventa të Konferencës së Hagës janë më të nevojshme në këtë fazë dhe nëse ato konventa janë të hapura për nënshkrim për shtetet joanëtare, si dhe modalitetet tjera të aderimit.

Në këtë rast, mund të përmenden veçoritë kryesore të poshtëshënuara të instrumenteve ndërkombëtare/supranacionale në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, edhe pse akoma nuk janë në fuqi në Kosovë:

- (i) Konventa e Konferencës së Hagës për Dokumentet mundëson përdorimin e kanaleve të dërgimit, kur një dokument gjyqësor, ose jashtëgjyqësor duhet të dërgohet nga një shtet palë i konventës tek një shtet tjetër palë, për t'u kryer shërbimi në këtë të fundit. Konventa merret kryesisht me transmetimin e dokumenteve; ajo nuk trajton rregulla substanciale, e as nuk përbën rregulla të tilla, që kanë të bëjnë me procesin e vërtetë të shërbimit. Korniza e ofruar nga

konventa është efikase dhe efiçente; të dhënat statistikore tregojnë se 66% e kërkesave ekzekutohen brenda 2 muajve.

(ii) Konventa e Konferencës së Hagës për Dëshmitë përcakton metodat e bashkëpunimit për marrjen e dëshmime jashtë shtetit në çështjet civile ose tregtare. Konventa, e cila vlen vetëm ndërmjet shteteve palë, mundëson marrjen e dëshmime (i) me anë të lehtë kërkesave, dhe (ii) nga agjentët diplomatikë ose konsullorë dhe komisionarët. Konventa ofron mjetet efektive për tejkalimin e dallimeve ndërmjet sistemeve juridike euro-kontinentale dhe atyre anglo-saksone sa i përket marrjes së provave.

(iii) Rregullorja e Bashkimit Evropian (BE) për Shërbimin e Dokumenteve kërkon të përmirësojë dhe shpejtojë transmetimin e dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet civile ose tregtare për shërbim ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Rregullorja vlen vetëm për shtetet anëtare të BE-së. Rregullorja mundëson mënyra të ndryshme të transmetimit dhe shërbimit të dokumenteve: transmetimin përmes agjencive transmetuese dhe pranuese, transmetimin përmes kanaleve konsullore ose diplomatike, shërbimin me anë të postës ose shërbimin e drejtpërdrejtë. Agjencitë transmetuese janë kompetente për transmetimin e dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore që duhet të dërgohen në një shtet tjetër anëtar. Agjencitë pranuese janë kompetente për pranimin e dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore nga një shtet tjetër anëtar. Autoriteti qendror është përgjegjës për ofrimin e informacioneve tek agjencitë transmetuese dhe për të kërkuar zgjidhje për çdo vështirësi që mund të dalë gjatë transmetimit të dokumenteve për shërbim. Rregullorja mundëson shtatë forma.

(iv) Rregullorja e BE-së për Marrjen e Provave kërkon të përmirësojë, thjeshtojë dhe shpejtojë bashkëpunimin ndërmjet gjykatave gjatë marrjes së provave. Rregullorja vlen ndërmjet të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, me përjashtim të Danimarkës. Rregullorja mundëson dy mënyra për marrjen e provave ndërmjet shteteve anëtare të BE-së: marrjen e provave përmes gjykatës që i kërkohet, dhe marrjes së drejtpërdrejta të provave nga gjykata kërkuese. Gjykata kërkuese është gjykata, para së cilës fillohet ose shqyrtohet procedura gjyqësore. Gjykata që i kërkohet është gjykata kompetente e një shteti tjetër anëtar të bëjë marrjen e provave. Organi qendror është përgjegjës për dhënien e informacioneve dhe kërkimin e zgjidhjeve për çdo vështirësi, që mund të haset sa i përket asaj kërkesë. Rregullorja mundëson dhjetë forma.

Ligjet formale

Ligjet formale të Republikës së Kosovës sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar përqëndrohen kryesisht në dispozitat për njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimeve të huaja.

(i) De lege ferenda, Projektligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private i Republikës së Kosovës (17 dhjetorit 2017) parashikon se në bazë të kushteve të neneve 159-173 të atij Projektligji, një aktgjykim i huaj do të jetë i barazvlefshëm me aktgjykimin e një gjykate të Republikës së Kosovës dhe i krijon pasojat juridike në Republikën e Kosovës vetëm pasi të njihet nga gjykata e Republikës së Kosovës.

(ii) De lege lata, sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet civile, procedura në ligjet formale të Republikës së Kosovës përshkruhet vetëm pjesërisht :

Në bazë të nenit 15, paragrafi 1.5 të Ligjit të Kosovës për Procedurën Përmbartimore (LKPP) aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbartim brenda territorit të Republikës së Kosovës, mund të konsiderohen dokumente të përmbartueshme në rast se dokumenti është pranuar për përmbartim. Sa i përket LKPP duhet të përmendet se në bazë të paragrafit 1.8, një vendim i përmbartueshëm që vërtetohet si Dokument Përmbartues Evropian duhet të njihet si dokument i përmbartueshëm.

Përveç kësaj, ka edhe ligje të tjera të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me ndihmën juridike të ndërsjellë në çështjet civile:

1. Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK) - përmban dispozita përmes së cilave përcaktohet detyrimi i organeve gjyqësore për t'i ofruar ndihmë organeve gjyqësore të huaja në lidhje me procedurat që zhvillohen pranë tyre, në bazë të marrëveshjeve bilaterale apo në kushte të reciprocitetit. LPK përcakton se cili ligj zbatohet gjatë ekzekutimit të kërkesave. Po ashtu, parashihen kushte formale për lejueshmërinë e kërkesave të pranuar nga jashtë.
2. Ligji Nr. 05/L-083 për Falimentimin - ky ligj rregullon falimentimin me element ndërkombëtar. Përmban dispozita për ofrimin e ndihmës lidhur me procedurën e huaj falimentuese si dhe për njohjen e procedurës së huaj duke përfshirë rregullimin e kërkesës për njohje të procedurës së huaj, prezumimet në lidhje me njohjen e procedurës së huaj, vendosjen për njohje të procedurës së huaj, masat e përkohshme, efektet e njohjes së procedurës së huaj kryesore etj.
3. Ligji NR. 02/L-75 për Arbitrazhin - përcakton të drejtën kompetente që zbatohet tek rastet e arbitrazhit me element ndërkombëtar dhe rregullon njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, duke përcaktuar

formën e kërkesës, gjykatën kompetente për njohje dhe ekzekutim, si dhe rastet kur refuzohet njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të huaj.

4. Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat - përcakton kompetencën e gjykatave themelore për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja.

Aktet nënligjore

Procedura për ndihmën ndërkombëtare rregullohet kryesisht me Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Ndihmës Juridike Ndërkombëtare në Çështjet Penale dhe Civile (UA) të Ministrisë së Drejtësisë të vitit 2009, si legjislacion sekondar.: Neni 1 i Udhëzimit Administrativ e bënë të qartë se është instrumenti kryesor i cili "përcakton procedurat për ndihmën juridike ndërkombëtare (NJDNJN) për çështjet civile....". Gjithashtu, ky Udhëzim ofron udhëzime si për "NJND-të që i drejtohen shteteve të huaja" nga Republika e Kosovës ashtu edhe NJDNJN-të të cilat "pranohen nga Republika e Kosovës prej shteteve të huaja".

Krahasimi me shtetet tjera

Republika e Kosovës paraqet rast të veçantë dhe ndoshta unik në rajon dhe më gjerë sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Kjo për shkak se siç është theksuar më lartë, Republika e Kosovës si shtet i ri dhe për shkak të statusit politik, ende nuk është anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare dhe rrjedhimisht, as e instrumenteve ligjore që e rregullojnë këtë fushë.

Për dallim, shumica (të gjitha) shtetet e rajonit dhe ato evropiane janë anëtare të Konventave të Konferencës së Hagës dhe akteve të tjera ndërkombëtare që e rregullojnë këtë fushë. Andaj, praktikat e shteteve tjera të shtjelluara më poshtë nuk mund të zbatohen përshtatshmërisht në Republikën e Kosovës.

Për qëllim të kësaj analize, Ministria e Drejtësisë ka realizuar një hulumtim të rregullimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në vendet e rajonit:

Shqipëria: Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile bazohet në marrëveshjet shumëpalëshe. Shqipëria është nënshkruese e këtyre konventave në fushën civile: Konventa e Hagës për Njoftimin dhe Dorëzimin Jashtë Shtetit të Dokumenteve Gjyqësore dhe Jashtëgjyqësore në Fushën Civile dhe Tregtare; Konventa Civile e Hagës për Korrupsionin; Konventa e Hagës për Procedurën Civile; Konventa e Hagës për Marrjen e Dëshmive Jashtë Shtetit në Çështjet Civile ose Tregtare; Konventa e Hagës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në Fushën Civile dhe Tregtare; Konventa e Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin për Birësimet Jashtë Vendit; Marrëveshja Evropiane për Transmetimin e Kërkesave të

Ndihmës Gjyqësore; Protokoll Shtesë i Marrëveshjes Evropiane për Transmetimin e Kërkesave për Ndihmë Gjyqësore dhe të Raportit Shpjegues.

Kroacia: Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile bazohet në Ligjin për Procedurën Civile, konkretisht nenet 181-184. Gjykatat do të ofrojnë ndihmën ligjore për gjykatat e huaja në rastet e parashikuara me traktate ndërkombëtar dhe në raste reciproke.

Mali i Zi: Kontratat bilaterale të lidhura ndërmjet Malit të Zi dhe shteteve individuale janë një bazë ligjore për bashkëpunimin në fushat që janë të rregulluara ndërmjet Malit të Zi dhe vendeve nënshkruese. Për çështjet që lindin në marrëdhëniet e tyre, por të cilat nuk janë të rregulluara me marrëveshje dypalëshe, zbatohen konventat shumëpalëshe, ndër të cilat më të rëndësishmet janë: Konventa e Hagës për Procedurën Civile e vitit 1954, Konventa e Hagës për Lehtësimin e Qasjes Ndërkombëtare në Gjykata e citit 1980, Konventa Evropiane për të Drejtat e Fëmijës, Konventa e Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës e vitit 1980 dhe Konventa e Hagës për të drejtën e zbatueshme për detyrimin e mbajtjes e vitit 1956 marrjen e pensionit ushqimor jashtë vendit të 1956.

Bosnje dhe Hercegovina: Ndihma dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar bazohet në traktatet ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe që janë të detyrueshme për Bosnje dhe Hercegovinën. Ligji për Procedurën Civile (Gazeta Zyrtare e Republikës Serbe të Bosnjës, nr. 58/2003) dhe Ligji për Procedurën Civile (Gazeta Zyrtare e Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës, Nr. 53/2003) parashikojnë që gjykatat do të ofrojnë ndihmë juridike për gjykatat e huaja në rastet e parapara me traktate ndërkombëtare si dhe në rastet e reciprocitet. Dispozita të ngjashme janë të përfshira në Ligjin për Procedurën Civile pranë Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e BeH-së, nr. 30/04) dhe Ligjit mbi Procedurën Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e Rrethit Brçkonë BeH, Nr.5 / 00).

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Qëllimi i këtij koncept dokumenti është analizimi i fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në këto çështje.

Objektivat

Objektiva kryesore është përmirësimi i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Objektiva specifike janë:

1. Përcaktimi i rregullave për trajtimin e kërkesave të organeve të huaja gjyqësore për shërbim të dokumenteve, marrjen e dëshmive , ekzekutimin e aktgjykimeve të huaja;
2. Përcaktimi i rregullave për trajtimin e kërkesave të organeve gjyqësore të Kosovës drejtuar organeve gjyqësore të vendeve tjera për shërbim të dokumenteve, marrjen e dëshmive , ekzekutimin e aktgjykimeve;
3. Harmonizimi i procedurave të ofrimit së ndihmës juridike ndërkombëtare në pajtim me Aktet përkatëse të Konferencës së Hagës dhe BE-së, të cilat mbulojnë këtë fushë, të listuara më poshtë:

- Konventa e Hagës për Dërgimin e Dokumenteve, e vitit 1965;
- Konventa e Hagës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Aktgjykimeve të Huaja;
- Konventa e Hagës për Marrjen e Dëshmive Jashtë Vendit në Çështjet Civile ose Komerciale;
- Konventa e Hagës për Heqjen e Kriereve për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaja;
- Konventa e Hagës për Zgjedhjen e Gjykatave;
- Rregullorja (BE) Nr. 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 12 dhjetor 2012 për juridiksionin dhe ekzekutimin e aktgjykimeve në çështjet civile dhe komerciale (ndryshim);
- Rregullorja (BE) Nr. 606/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 12 qershor 2013 për njohjen e dyanshme për masat mbrojtëse në çështjet civile;
- Rregullorja (KE) Nr. 4/2009 e datës 18 dhjetor 2008 për Juridiksionin, të drejtën e zbatueshme, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve dhe bashkëpunimin në çështjet që kanë të bëjnë me detyrimet e mbajtjes;
- Rregullorja (BE) Nr. 650/2012 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 4 korrik 2012 për Juridiksionin, drejtën e zbatueshme , njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve dhe njohjen dhe ekzekutimin e instrumenteve autentike në çështjet e trashëgimisë dhe krijimin e Certifikatës Evropiane për Trashëgiminë;
- Rregullorja (BE) 2015/848 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 20 maj 2015 për procedurat e falimentimit;
- Rregullorja (KE) Nr. 1896/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 12 dhjetor 2006 për krijimin e rregullit evropian për procedurat e pagesës;
- Rregullorja (KE) Nr. 861/2007 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 korrik 2007 për Krijimin e procedurës evropiane për kërkesat e vogla;
- Rregullorja (KE) Nr. 805/2004 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 21 prill 2004 për Krijimin e rregullit evropian të zbatimit për kërkesat e pa kontestuara;
- Rregullorja (BE) Nr. 655/2014 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 15 maj 2014 për Procedurën e krijimi të rregullit evropian për ruajtjen e

llogarisë për lehtësimin e kthimit të borxhit ndërkufitar në çështjet civile dhe komerciale;

- Rregullorja (BE) Nr. 1215/2012 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 12 dhjetor 2012 për Juridiksionin dhe njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimeve në çështjet civile dhe komerciale;
- Rregullorja (KE) Nr. 1393/2007 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 13 nëntor 2007 për Shërbimin e Shteteve Anëtare me dokumente gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile dhe komerciale (shërbimin e dokumenteve), dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1348/2000;

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Status Quo

Opsioni i parë është që të mos ndryshohet korniza ligjore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në Republikën e Kosovës. Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat në Kosovë do të vazhdonin të zbatonin Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Ndhmës Juridike Ndërkombëtare në Çështjet Penale dhe Civile dhe ligjet vendore, si Ligjin për Procedurën Kontestimore, Ligjin për Zgjedhjen e Konfliktit të Ligjeve.

Opsioni 2: Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ

Duke marrë parasysh bazën ligjore ekzistuese për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në Republikën e Kosovës, opsioni i dytë është ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave të UA-së në mënyrë që të evitohen pengesat e kohëpaskohshme, sidomos ato të natyrës procedurale, të cilat janë shfaqur në praktikë gjatë ofrimit dhe gjatë kërimit të ndihmës juridike në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Opsioni 3: Miratimi i Ligjit për fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Rregullimi i fushës së Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile mund të bëhet duke hartuar një politikë të re, respektivisht një ligji të ri, që paraqet mundësinë e vetme përmes së cilës do të përmbushej objektivi për harmonizimin e legjislacionit që rregullon këtë fushë me legjislacionin e BE-së. Hartimi i një politike të re do të evitonte pengesave ligjore dhe praktike të paraqitura në këtë fushë dhe do të mundësonte ofrimin e ndihmës juridike të ndërsjellë në mënyrë efektive.

Duke marrë parasysh faktin se Republika e Kosovës nuk është pjesë e Konferencës së Hagës, ose aderuese e konventave të kësaj organizate apo konventave të tjera që rregullojnë këtë aspekt të drejtësisë, si dhe duke marrë parasysh se Ministria e Drejtësisë si autoriteti qendror për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështjet civile dhe meqenëse Republika e Kosovës nuk ka një bazë të unifikuar ligjore në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, gjatë trajtimit të kërkesave që

kanë të bëjnë me ndihmën juridike në rastet civile, Ministria e Drejtësisë dhe gjyqësori janë përballur me probleme dhe vështirësi për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore adekuate në këtë drejtim.

Ndër kërkesat e bëra nga gjyqësori është miratimi i ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në fushën civile, i cili do të rregullojë këtë fushë në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të lartë në mënyrë që të lehtësohet ekzekutimi i kërkesave të parashtruara nga organet gjyqësore të huaja tek organet gjyqësore të Republikës së Kosovës dhe anasjelltas.

Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje civile, në pjesën e dispozitave të përgjithshme do të definonte se çka konsiderohet 'ndihmë juridike' dhe në lidhje me cilat procedura mund të ofrohet dhe kërkohet ndihma juridike. Po në pjesën e përgjithshme, do të përcaktohej Autoriteti Qendror për transmetim të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe roli që ka gjatë procedimit të kërkesave. Përmes këtij akti, do të rregulloheshin në mënyrë të qartë kushtet formale që duhet t'i plotësojë një kërkesë për tu konsideruar e pranueshme. Ligji do të rregullonte edhe rastet kur ndihma nuk mund të ofrohet për shkak se ekzistojnë pengesat ligjore.

Ky Ligj, në kapituj të ndarë, do të përcaktonte format në të cilat konsiston ndihma që ofrohet apo kërkohet, si ndihma që ofrohet në shërbim të dokumenteve dhe letërthirrjeve, ndihma në marrjen e provave, dhe njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja. Ky Ligj do të pasqyronte saktë praktikën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe do të unifikonte zbatimin e procedurave të zbatimit ndërmjet organeve gjyqësore vendore me ato të shteteve tjera, sidomos me BE-në, e cila e lehtëson punën e përditshme të Ministrisë së Drejtësisë, si organi qendror në zbatimin e kërkesave të ndryshme të gjykatave në çështjet civile, gjithashtu e lehtëson edhe punën e përditshme të gjyqësorit vendor në ekzekutimin e këtyre kërkesave që vijnë nga gjykatat e huaja dhe anasjelltas.

Gjatë hartimit të këtij Ligji, Ministria e Drejtësisë do t'i kushtoj rëndësi të veçantë harmonizimit me dispozitat e ligjeve tjera që prekin këtë fushë, si Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opcionit	Ndryshimi i qasjes ekzistues të zbatimit	Ligji i ri për fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në Çështjet Civile
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i	Republika e Kosovës	Republika e Kosovës

shënjestruar		
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Qeveria (Ministria e Drejtësisë) dhe Gjykatat Themelore	Qeveria (Ministria e Drejtësisë) dhe Gjykatat Themelore
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	Qeveria (Ministria e Drejtësisë)	Qeveria (Ministria e Drejtësisë)
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Udhëzimi Administrativ për Procedurën e Ndihmës Juridike Ndërkombëtare në Çështjet Penale dhe Civile (UA)	Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat	Jo	Jo
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Po	Po
Udhëzimet dhe kodet	shih më lartë	Jo
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni	Pas miratimit të Udhëzimit	Pas shpalljes në Gazetën Zyrtare

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

Opsioni 1: *Status quo*

Nuk pritet asnjë përfitim duke e vazhduar status quon.

Opsioni 2: *Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ*

Ndryshimi dhe plotësimi i UA-së ekzistuese do t'i mundësonte Ministrisë së Drejtësisë, së paku të ofrojë rregulla të përditësuara për trajtimin e kërkesave hyrëse dhe dalëse për ndihmën juridike ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, korniza ekzistuese ligjore do të përfundohej dhe si zgjidhje minimale e brendshme e pranueshme do të trajtoheshin në mënyrën e duhur kushtet formale dhe disa aspekte procedurale të kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë në çështjet civile.

Opsioni 3: *Miratimi i Ligjit për fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile*

Përveç plotësimit të zbrazëtirës së kornizës ligjore ekzistuese për ndihmën juridike ndërkombëtare, Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për Çështjet Civile do të

plotësonte në masë të madhe mungesën e anëtarësisë së Republikës së Kosovës në Konferencën e Hagës dhe aderimin në Konventat e saj. Ai do të pasqyronte saktë praktikën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe do të unifikonte zbatimin e procedurave të zbatimit ndërmjet organeve gjyqësore vendore me ato të shteteve tjera, sidomos me BE-në, e cila e lehtëson punën e përditshme të Ministrisë së Drejtësisë, si organi qendror në zbatimin e kërkesave të ndryshme të gjykatave në çështjet civile, gjithashtu e lehtëson edhe punën e përditshme të gjyqësorit vendor në ekzekutimin e këtyre kërkesave që vijnë nga gjykatat e huaja dhe anasjelltas.

Kështu që, nëse miratohet opsioni 3 i këtij Koncept Dokumenti atëherë do të kenë përfitim fushat e theksuara më poshtë:

- Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet civile do të zbatohet në atë mënyrë që të jetë i harmonizuar me *Aquis communautaire* dhe me Konventat e Konferencës së Hagës.
- Kërkesat e gjyqtarëve në Kosovë në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile do të plotësoheshin duke ofruar bazën ligjore për të trajtuar kërkesat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.
- Do të rritet siguria juridike për ata që janë të përfshirë në zbatim të këtij Ligji dhe do të rritet efikasiteti i procedurave që kryhen.
- Procedurat për ofrimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile do të jenë më të përshtatshme.
- Do të ofrohet reciprociteti në bazë ligjore, si parim kryesor i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar jokontraktual.

Të gjitha këto aspekte do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në qëllimet dhe objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në raport me procesin e integritimit në Bashkimin Evropian

Pasojat negative

Opsioni 1: *Status quo*

Mosgatishmëria e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të ndërmarrë masat e nevojshme për të ndryshuar ose plotësuar UA-në, ose të miratojë Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështje civile, çon në vështirësi në ofrimin e ndihmës juridike në çështjet civile.

Megjithatë, UA-ja ofron vetëm një përshkrim të gjerë të procedurave që duhet të ndiqen. Kjo UA është treguar se ka mangësi sa i përket dispozitave që rregullojnë këtë fushë të rëndësishme të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, meqenëse është e tejkualuar, si pasojë e plotësim ndryshimint të ligjeve të reja sektoriale, si Ligji për

Procedurën Kontestimore, Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, si dhe Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private, të cilat e bëjnë të domosdoshëm rishikimin e këtij Udhëzimi për të siguruar normativën e pajtueshmërisë.

Pastaj, UA-ja nuk përmbush kërkesat e bëra nga gjyqësori, dhe ekspertët në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar sa i përket vështirësi gjatë punës praktike si rezultat i mungesës së rregullave të përcaktuara nga UA-ja, dhe në këtë mënyrë do të vazhdonte zvarritja e procedurave gjyqësore

Për më tepër, në bazë të UA-së do të jetë i pamundur harmonizimi me *Acquis Communautaire* dhe Konventat e Konferencës së Hagës për praktikën e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet civile.

Si përfundim, nuk ka asnjë të mirë nëse ruhet status quo-ja. Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat do të vazhdojnë të ofrojnë ndihmë juridike të ndërsjellë siç kanë bërë deri më tash, por duke mos u shmangur pengesat e lartpërmendura ligjore dhe praktik, Kështu, rrezikohet cenimi i të drejtës së palëve për gjykim të drejtë dhe imazhi i Republikës së Kosovës në raport me shtetet tjera

Opsioni 2: *Ndryshimi i UA-së*

Udhëzimi Administrativ 2009/1-09, është nxjerrë me qëllim të ushtrimit të përgjegjësisë dhe përmbushjes së mandatit të përcaktuar ligjor në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në lëmin civil dhe penal, të përcaktuar me kodet dhe ligjet të cilat kanë dispozita ligjore që i referohen bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe penale. Këtij Udhëzimi i mungon baza ligjore nga e cila do të duhej të derivonte. Andaj, plotësim ndryshimi i këtij Udhëzimi përkitazi me procedurat e parapara për hartimin e legjislacionit, nuk është i mundur për faktin se nuk ka bazë ligjore mbi të cilën mund të nxirret .

Po ashtu, për shkak të natyrës ligjore të këtij Udhëzimi, ndryshimi i dispozitave të tij nuk do të jetë bazë e duhur për plotësimin e ligje tjera që rregullojnë këtë fushë siç janë Ligji për Procedurën Përmbartimore, Ligji për Procedurën Kontestimore, Ligji për Arbitrazhin, Ligji për procedurën e falimentimit dhe Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Në fund, duhet të merret parasysh se meqenëse Republika e Kosovës nuk është pjesë e asnjë konvente ndërkombëtare që rregullon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, një akt nënligjor siç është UA-ja, nuk do të përmbush të gjitha kriteret specifike në bazë të parimit të reciprocitetit. Në këtë mënyrë, do të pengoheshin në mënyrë jo të duhur edhe aktivitetet e tjera të Kosovës në fushën e bashkëpunimit juridik bilateral ose rajonal.

Opsioni 3: *Miratimi i Ligjit për fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile*
Nuk ka pasoja negative nga zbatimi i këtij opsioni.

Efektet Shpërndarëse

Kostot

Ministria e Drejtësisë ka bërë një vlerësim paraprak të ndikimit financiar, me ç'rast, analiza ka treguar se hartimi dhe miratimi i Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile nuk pritet të ketë ndikim as në burimet njerëzore e as shpenzimet buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë, ose gjyqësorit të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, edhe opsionet e tjera kanë treguar se nuk do të ketë ndryshime të tjera buxhetore.

Kapitulli 7: Konsultimi

Për rregullimin e fushës së lartpërmendur konsultimet kanë filluar më herët dhe si rezultat i këtyre konsultimeve është arritur në përfundimin se është e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me ligj të veçantë. Konsultimet kanë përfshirë ekspertë dhe njohës të kësaj fushe, përfaqësues të gjyqësorit, Këshilltarët Ligjorë të Zyrës së Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE), të cilët kanë shprehur pikëpamjet e tyre për nevojën e rregullimit të kësaj fushe. Opinioni i përgjithshëm i grupit konsultues si më sipër, qëndron në hartimin e një ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile, si opsioni më i përshtatshëm për të adresuar gjendjen aktuale.

Për qëllime të konsultimit, Ministria e Drejtësisë ka përgatitur një pyetësor për të siguruar të dhëna më të sakta për pasojat e mos rregullimit të kësaj fushe, rezultatet e të cilit janë të paraqitura në Kapitullin 2.

Në pajtim me Rregulloren 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, ky proces bëhet përmes metodave të ndryshme, përfshirë Platformën Elektronike për konsultimet publike dhe takimet direkte më palë të interesuara, konsultimi publik do të përfshijë të gjitha institucionet dhe kategoritë e shoqërisë qoftë ata me ndikim ose interes të lartë, apo ata të cilët mund të japin kontributin e tyre për shqyrtimin e opsioneve. Kontribut të rëndësishëm mund të japin të gjitha kategoritë e shoqërisë, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe ekspertët e projekteve të ndryshme të asistencës teknike në institucionet e Republikës së Kosovës.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Status quo

Udhëzimi Administrativ në fuqi ofron vetëm një përshkrim të gjerë të procedurave që duhet të ndiqen dhe në këtë mënyrë çon në vështirësi në ofrimin e ndihmës juridike në

çështjet civile. Përveç kësaj pamundësohet qasja në drejtësi nga qytetarët e vendit si një e drejtë themelore për realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e tyre përmes sistemit gjyqësor. Për më tepër qytetarëve të vendit i cenohet edhe e drejta në gjykim të drejtë, e garantuar me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Opsioni 2: Ndryshimi i UA-së

Kërkesat e gjyqtarëve dhe ekspertëve të kësaj fushe dhe akterëve të tjerë që hasin në vështirësi gjatë punës së tyre praktike nuk do të plotësohen, sepse Udhëzimi Administrativ nuk do të rregullonte në nivelin e duhur trajtimin e kërkesave për bashkëpunim juridik ndërkombëtar. Për shkak të hierarkisë së akteve ligjore, Udhëzimi nuk mund të ketë fuqinë juridike pasi nuk posedon bazë ligjore nga e cila derivon. Kjo çështje duhet të jetë kategori ligjore për të prodhuar efekt juridik dhe lidhshmëri me aktet tjera ligjore në të cilat përcaktohen rregulla për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

Opsioni 3:

Ndryshimi i politikave ekzistuese do të mundësonte lehtësimin e procedurave për të kërkuar dhe ofruar ndihmën juridike ndërkombëtar dhe do të fuqizonte më tej bashkëpunimin në përgjithësi me shtetet e rajonit dhe shtetet anëtare të BE-së. Me hartimin e një Ligji do të adresoheshin kërkesat e gjyqësorit për rregullim normativ të kësaj fushe me qëllim të unifikimit të procedurës dhe qartësisimit të rregullave. Në anën tjetër, Ligji i hartuar në frymën e Konventave të Konferencës së Hagës dhe *acquis communautaire* përkon me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropaine.

Nxjerrja e Ligjit i cili do të rregullon këtë fushë do të jetë njëri ndër elementet që do të ndikojë në krijimin dhe reformimin e sistemit juridik të Kosovës.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Ministria e Drejtësisë, si propozuese e këtij Koncept Dokumenti, i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës të miratojë opsionin 3 dhe të hartojë një Ligj të veçantë për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile, në mënyrë që të rritet siguria juridike për ata që preken nga ai, si dhe të rritet efikasiteti i procedurave që zhvillohen për kërkimin dhe ofrimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Kapitulli 10: Komunikimi

Ministria e Drejtësisë, në bashkëveprim me Ministritë e tjera të linjës, KGjK, PSBE dhe palët tjera të interesuara, do të jenë të përqendruar në ofrimin e informacioneve lidhur me detajet e procesit të hartimit të ligjit, ku do të merren parasysh propozimet dhe komentet e akterëve të ndryshëm relevantë si dhe konsultimet me ekspertët e kësaj fushe dhe shoqërinë civile.

Format e komunikimit pritet të jenë të ndryshme, të cilat variojnë nga takimet dhe grupet punuese dhe publikimet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe platformat tjera ku Ministria e Drejtësisë është prezente dhe aktive. Plani i komunikimit në mes të këtyre aktorëve parashihet të jetë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe me synim që të arrihet një debat konstruktiv rreth propozimeve në fjalë.